Ky i fundit më fton mua Noterin të mbaj proces-verbalin mbi zhvillimin e vetë asamblesë.

Kryetari deklaron dhe pranon se kjo asamble zhvillohet duke qenë pjesëmarrësit në të të lidhur ekskluzivisht nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit në bazë të nenit 106, paragrafi 2, të Dekretit Legjislativ nr. 18, datë 17 mars 2020, i ndryshuar në Ligjin nr. 27, datë 24 prill 2020 (efektet e të cilit janë shtyrë deri më 31 dhjetor 2020 me anë të Dekretit Legjislativ nr. 125, datë 7 tetor 2020).

Kryetari deklaron se marrin pjesë në asamble:

1) në lidhje telematike audio-video:

a) Z. STEFANO DI STEFANO, i dërguar i ortakut të vetëm Ministria e Ekonomisë e Financave, me seli në Roma, në Via XX Settembre n. 97, kod fiskal 80415740580, mbajtës i nr. 20.000 (njëzetë mijë) aksioneve pa vlerë nominale, të cilat përbëjnë të gjithë kapitalin e shoqërisë;


b) Këshilli i Administrimit, në personat e, përveç vetë atij:

- FABIO DANIELE MARIA LAZZERINI – Anëtar i Këshillit të Administrimit;
- LELIO FORNABAIO – Anëtar i Këshillit të Administrimit;
- SILVIO MARTUCELLI – Anëtar i Këshillit të Administrimit;

c) Bordi i Audituesve Ligjorë:

- PAOLO MARIA CIABATTONI – Kryetar i Bordit;
- GIOVANNI NACCARATO – Anëtar i Përhershëm i Bordit;
- MARINA SCANDURRA - Anëtare e Përhershme e Bordit.

Asiston i lidhur nëpërmjet sistemit telematik audio-video, me lejen e pjesëmarrësve, av. CARLO MIRABILE.


Për këtë qëllim, Kryetari deklaron se lidhjet telematike garantojnë identifikimin e pjesëmarrësve, pjesëmarrjen e tyre dhe ushtrimin e së drejtës së votës nga ana e përfaqësuesit të ortakut të vetëm dhe lejojnë të dëgjohen të gjithë pjesëmarrësit, që këta të dëgjojnë siç duhet zhvillimet gjatë asamblesë dhe të marrin pjesë në diskutim në mënyrë të menjëhershme si edhe mua Noterit të kuptoj zhvillimet gjatë asamblesë.
Të gjithë pjesëmarrësit konfirmojnë sa më sipër.

Kryetari deklaron dhe pranon se është siguruar për identitetin dhe legjitimitimin e përfaqësuesit të ortakut të vetëm, të anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe të atyre të Bordit të Audituesve Ligjorë dhe se është në gjendje të sigurojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë e të shpallë rezultatet e votimit.

Kryetari deklaron dhe pranon se:

- kjo asamble është thirrur në mënyrën e duhur, me urgjencë – në bazë të nenit 8 të statutit të shoqërisë – me anë të e-mail-eve të dërguara nëpërmjet postës elektronike, të dërguara më datë 12 nëntor 2020 me provën se e-mail është marrë të paktën tetë ditë para datës së zhvillimit të kësaj asambleje;
- janë të përfaqësuara nr. 20.000 (njëzetë mijë) aksione pa vlerë nominale të cilat përbëjnë të gjithë kapitalin e shoqërisë prej 20.000.000,00 Euro (njëzetë milionë euro e zero qindarka);
- janë respektuar rregullat mbi marrjen pjesë në asamble, edhe në bazë të sa parashikuar nga neni 106, paragrafi 2, i Dekretit Legjislativ nr. 18, datë 17 mars 2020, i ndryshuar në Ligjin nr. 27, datë 24 prill 2020 (efektet e të cilit janë shtyrë deri më 31 dhjetor 2020 me anë të Dekretit Legjislativ nr. 125, datë 7 tetor 2020);
- për sa më sipër asambleja e sotme është thirrur në formë të rregullt për të vendosur mbi çështjet në rend të ditës, me trajtimin e të cilave vijohet.

KOMUNIKIME TË KRYETARIT

Kryetari kujton se Shoqëria është themeluar me vendim të firmosur më datë 9 tetor 2020 nga Ministri i Ekonomisë e Financave Roberto Gualtieri, nga Ministri i infrastrukturave e transporteve Paola De Micheli, nga Ministri i zhvillimit ekonomik Stefano Patuanelli dhe nga Ministri i punës dhe politikave sociale Nunzia Catalfo (vendim i parashikuar nga neni 79 i Dekretit Legjislativ nr. 18, datë 17 mars 2020, i ndryshuar me anë të Ligjit nr. 27, datë 24 prill 2020, i ndryshuar nga neni 202 i Dekretit Legjislativ nr. 34, datë 19 maj 2020, i ndryshuar me anë të Ligjit nr. 77, datë 17 korrik 2020 dhe me nenin 87 të Dekretit Legjislativ nr. 104, datë 14 gusht 2020, i ndryshuar nga Ligji nr. 126, datë 13 tetor 2020), i regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me numër 1313 më datë 29 tetor 2020 e i publikuar më datë 30 tetor 2020 në faqen eeb të Ministrisë së ekonomisë e financave të Shtetit Italian (në vijim "VENDIM". Ky publikim është kryer në bazë të sa parashikuar nga VENDIMI dhe lë vend për çdo përmbushje në bazë të ligjit.

Në bazë të VENDIM-it – vijon Kryetari – me qëllimin për të nisur realisht veprimtarinë e Shoqërisë, është kërkuar dhe përfutur kodi fiskal, është hapur adresa e Postës Elektronike të Çertifikuar dhe është derdhur, nga Ministria e ekonomisë e financave, shuma prej

20.000.000,00 Euro (njëzetë milionë euro e zero qindarka) – që përbën të gjithë kapitalin e shoqërisë – në llogarinë rrjedhëse të hapur në emër të Shoqërisë.
Shoqëria është regjistruar pra në Regjistrin Tregtar të Roma-s më datë 16 nëntor 2020.
Shoqëria është pra tërësisht operative.
Asambleja pranon komunikimet e Kryetarit.

NDRYSHIM I NENEVE 3, 5 DHE 10 TË STATUTIT TË SHOQËRISË

Kryetari komunikon se ka lindur nevoja të ndryshohen nenet 3, 5 dhe 10 të statutit të shoqërisë sipas teksteve që përmbajnë dokumentat të cilat u janë shpërndarë të gjithë pjesëmarrësve në asamble.

Kryetari më kërkon që t'i bashkëlidhet këtij proces-verbali dokumenti që përmban krahasimin midis tekstit në fuqi dhe tekstit të ri ku janë pasqyruar ndryshimet e neneve 3, 5 dhe 10 të statutit.

Kryetari hap diskutimin.
Askush nuk e merr fjalën.
Kryetari fton, pra, asamblenë të marrë vendim.
Asambleja, pasi ka pranuar sa më sipër, me votën pro të së gjithë kapitalit të shoqërisë,
votë e shprehur me zë të lartë

vendos

1) të ndryshojë nenin 3, paragrafi 3, të statutit të shoqërisë si vijon:

"Neni 3
(Objekti)

1. I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI
2. I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI
3. Shoqëria do të mundë të kryejë të gjitha veprimet që do të vlerësojë se janë të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimit të objektit të shoqërisë, edhe nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta dhe, për këtë qëllim, do të mundë, kryesisht por pa u kufizuar vetëm në to:
 - a) të kryejë të gjitha veprimet në fushën e pasurive të paluajtshme, atyre të luajtshme, veprimet tregtare, industriale, financiare - përfshirë këtu dhënie e garancive në favor të shoqërive të cilat i përkasin të njëjtit grup – hipotekore dhe të shitjes së shërbimeve gjithsesi të lidhura me objektin e shoqërisë;
E PANDRYSHUESHME PJESA TJETËR".

2) të ndryshojë nenin 5, paragrafi 1, të statutit të shoqërisë si vijon:

"Neni 5
(Kapitali)

- 
1. Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 20.000.000,00 Euro (njëzetë milionë euro e zero qindarka) i ndarë në nr. 20.000 (njëzetë mijë) aksione të zakonshme pa vlerë nominale.
 2. I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI”.

3) të ndryshojë nenin 10, paragrafi 4, paragrafi 6.1 dhe paragrafi 6.5, të statutit të shoqërisë si vijon:

“Neni 10

(Këshilli i Administrimit)

1. I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI
2. I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI
3. I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI
4. Nëse gjatë vitit ushtrimor ndahen nga jeta një apo më shumë anëtarë të Këshillit të Administrimit, veprohet në bazë të nenit 2386 të Kodit Civil në përputhje me sa parashikuar nga paragrafi 1 lidhur me barazinë gjinore.
5. I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI
6. I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI
- 6.1 I PANDRYSHUAR PARAGRAFI DERI NË PIKËN d) me përjashtim d) veprimtari mësimdhënieje universitare të lëndëve juridike, ekonomike ose lëndëve të cilat kanë lidhje me sektorin operativ të shoqërisë apo gjithsesi të lidhura me veprimtarinë sipërmarrëse, pra

e) E PANDRYSHUAR PIKA

6.2 I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI

6.3 I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI

6.4 I PANDRYSHUAR I GJITHË PARAGRAFI

6.5 I PANDRYSHUAR NË TË GJITHË PARAGRAFËT PËRVEÇ DY TË FUNDIT TË CILËT NDRYSHOJNË SI VIJON:

Me qëllim aplikimin e kësaj pike 6.5, vendimi i aplikimit të dënimit në bazë të nenit 444 të kodit të procedurës penale është i barasvlershëm me vendimin e dënimit, përveç rastit të shuarjes së dënimit.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike 6.5, vendimet e marra nga autoritete të huaja, që përbëjnë shkaqe penguese, vlerësohen nga këshilli i administrimit në bazë të një gjykimi ekuivalence thelbësore me hipotezat e parashikuara e të rregulluara nga rregullorja e brendshme.”

Asambleja në përfundim, me votën pro të të gjithë kapitalit të shoqërisë **të shprehur me zë të lartë**, autorizon Kryetarin e Këshillit të Administrimit dhe Administratorin e Deleguar, me firmë të pavarur nga njëri-tjetri, të bëjnë të gjitha ndryshimet e mundshme formale, të vendimeve të marra si më sipër, të kërkuara me rastin e regjistrimit në Regjistrin Tregtar si edhe të kryejnë çdo veprim që mund të jetë i nevojshëm për sa më sipër.

Kryetari më kërkon që t'i bashkëlidhet këtij proces-verbali teksti i përditësuar i statutit të shoqërisë.

AUTORIZIM I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT PËR DHËNIEN E TAGRAVE KRYETARIT E TIJ NË BAZË TË NENIT 11 TË STATUTIT

Kryetari bën të ditur propozimin e Këshillit të Administrimit për të pajisur Kryetarin me tagrat si vijon:

1. drejtim dhe koordinim i funksioneve të brendshme: *internal audit, compliance*, ligjore dhe sekretarie të Këshillit të Administrimit;

2. në bashkërendim me Administratorin e Deleguar, marrëdhënie institucionale dhe rregullatore, përfshirë – por pa u kufizuar vetëm në to – ato me institucionet e BE-së, me Parlamentin, Qeverinë, Ministrinë, Organet institucionale dhe, në përgjithësi, autoritetet rregullatore të mbikëqyrjes dhe kontrollit;

3. në bashkërendim me Administratorin e Deleguar, strategjinë dhe përmbajtjen e komunikimit të jashtëm, të udhëzimeve, marrëdhënieve me mediat dhe mesazhet kyçe për t'u paraqitur si pozicionim nga ana e shoqërisë, edhe në marrëdhëniet institucionale.

Theksohet se tagrat e mësipërm janë dhënë vetëm për periudhën e qëndrimit në detyrë të Këshillit të parë. Në përfundim të afatit të qëndrimit në detyrë të Këshillit të parë të Administrimit apo në rast se, për çfarëdolloj arsye, Ing. Francesco Caio nuk do të jetë më Kryetar i Këshillit të Administrimit, tagrat e sipërpërmendura operative nuk janë më të vlefshme.

Kryetari referon gjithashtu se Këshilli i Administrimit mendon të veprojë si më sipër në sajë të nevojës për të siguruar, në fazën delikate të nisjes së veprimtarisë së Shoqërisë, një qendër të fortë, të kualifikuar e profesionale veprimtarish komplekse e me rëndësi të madhe. Kryetari ia jep fjalën Z. Stefano Di Stefano, përfaqësues i ortakut të vetëm, Ministrisë së ekonomisë e financave, i cili thekson se veprimtarinë e nisjes së aktivitetit sipërmarrës të shoqërisë, të cilat duhet të kryhen jo në vijimësi të së shkuarës, nxjerrin në pah nevojën për të ngritur, sa më shpejt, një strukturë operative në gjendje t'u përgjigjet objektivave industrialë-tregtarë të tregut dhe të garantojë efikasitet të veprimtarisë sipërmarrëse, me qëllimin për t'u ofruar shërbimin më të mirë e më me vlerë klientëve, qofshin këta sipërmarrje, individë apo familje.

Kjo do të duhet të ndodhë në përputhje të plotë me udhëzimet që mund të jepen nga Parlamenti dhe nga Institucionet e Bashkimit Evropian.

Përfaqësuesi i ortakut të vetëm kujton se, me vendimin e themelimit të Shoqërisë, është emëruar Presidenti i Shoqërisë, Ing. Francesco Caio për shkak të profilit të tij të lartë profesional, me objektivin për të vënë eksperiencën dhe profesionalizmin e tij domethënës në shërbim të objektivave të synuar.

Për pasojë, përfaqësuesi i ortakut të vetëm, në bazë të propozimit të Këshillit të Administrimit me të cilin është dakord, fton këtë të fundit, në bazë të nenit 11, paragrafi 11, fjalia e parë, të Statutit, të vijojë me sa më sipër përmendur dhe t'i japë Ing. Francesco Caio-s, President i Shoqërisë, tagrat e cituara.

Përfaqësuesi i ortakut të vetëm saktëson se autorizimi për dhënie e tagrave të mësipërme operative është dhënë duke pasur parasysh fazën e start-up të Shoqërisë dhe, pra, se ky autorizim kufizohet në kohë deri në përfundim të mandatit të Këshillit të parë të Administrimit.

Në përfundim të këtij mandati ose në rast se, për çfarëdo arsye, Ing. Francesco Caio nuk do të jetë më President i Shoqërisë, autorizimi i mësipërm nuk do të jetë më i vlefshëm.

Kryetari hap diskutimin.

Askush tjetër nuk e merr fjalën.

Kryetari fton pra asamblenë të vendosë.

Asambleja, duke pranuar sa më sipër, me votën pro të të gjithë kapitalit të shoqërisë, **të shprehur me zë të lartë**

vendos

të autorizojë Këshillin e Administrimit t'i japë Ing. Francesco Caio-s, President i Shoqërisë – në bazë të nenit 11, paragrafi 11, të Statutit – tagrat operative sipas propozimit të bërë nga Këshilli i Administrimit dhe, pra, në fushat si vijon:

(a) drejtim dhe koordinim i funksioneve të brendshme: *internal audit, compliance*, ligjore dhe sekretarie të Këshillit të Administrimit;

(b) në bashkërendim me Administratorin e Deleguar, marrëdhënie institucionale dhe rregullatore, përfshirë – por pa u kufizuar vetëm në to – ato me institucionet e BE-së, me Parlamentin, Qeverinë, Ministrinë, Organet institucionale dhe, në përgjithësi, autoritetet rregullatore të mbikëqyrjes dhe kontrollit;

(c) në koordinim me Administratorin e Deleguar, strategjinë dhe përmbajtjen e komunikimit të jashtëm, të udhëzimeve, marrëdhënieve me mediat dhe mesazhet kyçe për t'u paraqitur si pozicionim nga ana e shoqërisë, edhe në marrëdhëniet institucionale.

Theksohet se tagrat e mësipërm janë dhënë vetëm për periudhën e qëndrimit në detyrë të Këshillit të parë. Në përfundim të afatit të qëndrimit në detyrë të Këshillit të parë të Administrimit apo në rast se, për çfarëdolloj arsye, Ing. Francesco Caio nuk do të jetë më Kryetar i Këshillit të Administrimit, tagrat e sipërpërmendura operative nuk janë më të vlefshme.

Kryetari falënderon ortakun për besimin e treguar dhe Këshillin e Administrimit për punën e kryer.

Në vijim, duke qenë se nuk ka gjë tjetër për të vendosur, Kryetari deklaroi diskutimin të mbyllur dhe punimet e asamblesë të përfunduara.
Ora është tetë e pesëdhjetë minuta."

Në bazë të sa më sipër i bashkëlidhet ky proces-verbal:

- sub "A" dokumenti që përmban krahasimin midis tekstit në fuqi dhe tekstit të ri me ndryshimet e neneve 3, 5 dhe 10 të Statutit;
- sub "B" teksti i përditësuar i Statutit.

Unë Noteri, pasi më është kërkuar, kam mbajtur këtë proces-verbal i cili është shkruar nga unë Noteri edhe në përmbushje të rregulloreve në fuqi lidhur me situatën epidemiologjike të shkaktuar nga COVID-19.

Ky proces-verbal nënshkruhet nga unë Noteri në orën nëntë e tridhjetë minuta të datës njëzetë nëntor dy mijë e njëzetë.

I shkruar pjesërisht nga person i besuar i imi e pjesërisht nga unë noteri, ky proces-verbal është i përbërë nga katër fletë dhe shtrihet në dymbëdhjetë faqe të plota dhe njëzetë rreshta në këtë faqe.

Firmosur nga PAOLO CASTELLINI – Noter.

(firmë dhe vulë)

Dokumenti bashkëlidhur "A"/Numër regjistrimi 24183



**Dokument krahasues midis tekstit në fuqi të neneve 3, 5 dhe 10 të Statutit të
Italia Trasporto Aereo S.p.A.
dhe tekstit të ri**

Ndryshimet janë vënë në dukje me **gërma të theksuara** në kolonën "teksti i ri" dhe fjalët e fshira janë shënuar me vijë në kolonën "teksti në fuqi".

STATUTI

Italia Trasporto Aereo S.p.A.

<u>TEKSTI NË FUQI</u>	<u>TEKSTI I RI</u>
Neni 3 (Objekti)	Neni 3 (Objekti)
<p>1. Shoqëria, që operon nën regjimin e së drejtës private, duke ndjekur objektiva të natyrës tregtare dhe industriale në përputhje me rregulloren e brendshme dhe atë të Bashkimit Evropian, përveç sa parashikuar nga paragrafët 3 dhe 4-bis të nenit 79 të Ligjit nr. 18, datë 17 mars 2020, i ndryshuar e i plotësuar, ka për objekt ushtrimin e veprimtarisë sipërmarrëse në sektorin e transportit ajror të njerëzve dhe mallrave, kundrejt ndërtimit dhe aprovimit të planit industrial të zhvillimit dhe zgjerimit të ofertës që përfshin strategji strukturore të produktit në bazë të paragrafit 4-bis si më sipër.</p> <p>Për realizimin e objektit të shoqërisë, shoqëria vepron nëpërmjet:</p> <p>a) përdorimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose nëpërmjet shoqërive në të cilat ka pjesëmarrje dhe/ose enteve dhe/ose konsorciumeve, linjave dhe lidhjeve ajrore për transportin e njerëzve dhe sendeve në Itali, midis Italisë dhe Vendeve të huaja dhe në Vende të huaja, përfshirë këtu promovimin, vënien në jetë dhe administrimin e nismave e shërbimeve në fushën e transportit ajror;</p> <p>b) kryerjen, drejtpërdrejt apo jo, në Itali e në Vende të huaja, të veprimtarive të riparimit apo të mirëmbajtjes së avionëve, të qiradhënies/qiramarrjes dhe të asistencës dhënë të tretëve, të "ground-handling", si edhe të veprimtarive ajrore-didaktike, shërbimeve dhe punimeve në avionë në përgjithësi, pa asnjë përjashtim;</p> <p>c) kryerjen e çdo veprimtarie tjetër</p>	<p>1. Shoqëria, që operon nën regjimin e së drejtës private, duke ndjekur objektiva të natyrës tregtare dhe industriale në përputhje me rregulloren e brendshme dhe atë të Bashkimit Evropian, përveç sa parashikuar nga paragrafët 3 dhe 4-bis të nenit 79 të Ligjit nr. 18, datë 17 mars 2020, i ndryshuar e i plotësuar, ka për objekt ushtrimin e veprimtarisë sipërmarrëse në sektorin e transportit ajror të njerëzve dhe mallrave, kundrejt ndërtimit dhe aprovimit të planit industrial të zhvillimit dhe zgjerimit të ofertës që përfshin strategji strukturore të produktit në bazë të paragrafit 4-bis si më sipër.</p> <p>Për realizimin e objektit të shoqërisë, shoqëria vepron nëpërmjet:</p> <p>a) përdorimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose nëpërmjet shoqërive në të cilat ka pjesëmarrje dhe/ose enteve dhe/ose konsorciumeve, linjave dhe lidhjeve ajrore për transportin e njerëzve dhe sendeve në Itali, midis Italisë dhe Vendeve të huaja dhe në Vende të huaja, përfshirë këtu promovimin, vënien në jetë dhe administrimin e nismave e shërbimeve në fushën e transportit ajror;</p> <p>b) kryerjen, drejtpërdrejt apo jo, në Itali e në Vende të huaja, të veprimtarive të riparimit apo të mirëmbajtjes së avionëve, të qiradhënies/qiramarrjes dhe të asistencës dhënë të tretëve, të "ground-handling", si edhe të veprimtarive ajrore-didaktike, shërbimeve dhe punimeve në avionë në përgjithësi, pa asnjë përjashtim;</p> <p>c) kryerjen e çdo veprimtarie tjetër</p>

ndihmëse, plotësuese e të lidhur me veprimtaritë e sipërpërmendura.

2. Përmbushja e objektit të shoqërisë mund të arrihet edhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara apo atyre në të cilat Shoqëria ka pjesëmarrje, për administrimin e degëve të veçanta dhe për zhvillimin e sinergjive e aleancave me subjekte të tjerë publikë e privatë, italianë e të huaj. Shoqëria autorizohet, gjithashtu, të blejë dhe marrë me qira, edhe nëpërmjet marrëveshjeve të drejtpërdrejta, degë shoqërisht të subjekteve të pajisura me leje të transportit ajror të lëshuara nga Enti Kombëtar për Aviacionin Civil, edhe nën administrim të jashtëzakonshëm.

3. Shoqëria do të mundë të kryejë të gjitha veprimet që do të vlerësojë se janë të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimit të saj, edhe nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta dhe, për këtë, qëllim, do të mundë, kryesisht por pa u kufizuar vetëm në to:

a) të kryejë të gjitha veprimet në fushën e pasurive të paluajtshme, atyre të luajtshme, veprimet tregtare, industriale, financiare - përfshirë këtu dhënien e garancive reale edhe në favor të të tretëve - hipotekore dhe të shitjes së shërbimeve gjithsesi të lidhura me objektin e shoqërisë;

b) të ketë pjesëmarrje, në mbështetje të veprimtarive që përbëjnë objektin e shoqërisë dhe jo me qëllim pozicionimi, pjesëmarrje, kuota apo dividend në shoqëri të tjera, konsorciume, sipërmarrje apo ente të çfarëdo natyre, si italiane ashtu edhe të huaja - të cilat rezultojnë të jenë në gjendje të qëndrueshme financiare, pasurore dhe ekonomike dhe me perspektivë për të prodhuar të ardhura;

c) të marrë pjesë në tendera publikë si edhe të lidhë me Shtetin Italian marrëveshje me qëllim kryerjen e shërbimeve publike;

d) të zhvillojë sinergji e aleanca me subjekte të tjerë publikë e privatë, italianë e të huaj, si edhe të lidhë çdo lloj marrëveshjeje me të tretë, përfshirë këtu Shtete të huaja, për zhvillimin e veprimtarisë së transportit ajror edhe jashtë territorit italian.

KAPITALI – AKSIONE

ndihmëse, plotësuese e të lidhur me veprimtaritë e sipërpërmendura.

2. Përmbushja e objektit të shoqërisë mund të arrihet edhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara apo atyre në të cilat Shoqëria ka pjesëmarrje, për administrimin e degëve të veçanta dhe për zhvillimin e sinergjive e aleancave me subjekte të tjerë publikë e privatë, italianë e të huaj. Shoqëria autorizohet, gjithashtu, të blejë dhe marrë me qira, edhe nëpërmjet marrëveshjeve të drejtpërdrejta, degë shoqërisht të subjekteve të pajisura me leje të transportit ajror të lëshuara nga Enti Kombëtar për Aviacionin Civil, edhe nën administrim të jashtëzakonshëm.

3. Shoqëria do të mundë të kryejë të gjitha veprimet që do të vlerësojë se janë të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimit të saj, edhe nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta dhe, për këtë, qëllim, do të mundë, kryesisht por pa u kufizuar vetëm në to:

a) të kryejë të gjitha veprimet në fushën e pasurive të paluajtshme, atyre të luajtshme, veprimet tregtare, industriale, financiare - përfshirë këtu dhënien e garancive **në favor të shoqërive të cilat i përkasin të njëjtit grup** - hipotekore dhe të shitjes së shërbimeve gjithsesi të lidhura me objektin e shoqërisë;

b) të ketë pjesëmarrje, në mbështetje të veprimtarive që përbëjnë objektin e shoqërisë dhe jo me qëllim pozicionimi, pjesëmarrje, kuota apo dividend në shoqëri të tjera, konsorciume, sipërmarrje apo ente të çfarëdo natyre, si italiane ashtu edhe të huaja - të cilat rezultojnë të jenë në gjendje të qëndrueshme financiare, pasurore dhe ekonomike dhe me perspektivë për të prodhuar të ardhura;

c) të marrë pjesë në tendera publikë si edhe të lidhë me Shtetin Italian marrëveshje me qëllim kryerjen e shërbimeve publike;

d) të zhvillojë sinergji e aleanca me subjekte të tjerë publikë e privatë, italianë e të huaj, si edhe të lidhë çdo lloj marrëveshjeje me të tretë, përfshirë këtu Shtete të huaja, për zhvillimin e veprimtarisë së transportit ajror edhe jashtë territorit italian.

KAPITALI – AKSIONE

<p style="text-align: center;">Neni 5 (Kapitali)</p> <p>1. Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 20.000.000,00 Euro (njëzetë milionë euro/00) i ndarë në nr. 20.000 (njëzetë mijë/00) aksione të zakonshme pa vlerë nominale.</p> <p>2. Kapitali i shoqërisë mund të rritet edhe nëpërmjet kontributit në natyrë dhe kreditimeve.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 5 (Kapitali)</p> <p>1. Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 20.000.000,00 Euro (njëzetë milionë euro e zero qindarka) i ndarë në nr. 20.000 (njëzetë mijë) aksione të zakonshme pa vlerë nominale.</p> <p>2. Kapitali i shoqërisë mund të rritet edhe nëpërmjet kontributit në natyrë dhe kreditimeve.</p>
<p style="text-align: center;">KËSHILLI I ADMINISTRIMIT Neni 10 (Këshilli i Administrimit)</p> <p>1. Shoqëria administrohet nga një këshill administrimit i përbërë nga një minimum prej shtatë në një maksimum prej njëmbëdhjetë anëtarësh, edhe jo ortakë, të emëruar nga asambleja, e cila cakton numrin e tyre. Në çdo rast, të paktën dy të pestat e anëtarëve të këshillit të administrimit duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar duke e rrumbullakosur numrin në njësinë më të madhe.</p> <p>2. Asambleja e zakonshme, edhe gjatë mandatit, mund të ndryshojë numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit, gjithmonë brenda kufijve sipas paragrafit 1. Nëse asambleja do të rrisë numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit, këta të fundit do të qëndrojnë në detyrë deri në përfundimin e afatit të qëndrimit në detyrë të anëtarëve ekzistues të këshillit të administrimit.</p> <p>3. Anëtarët e këshillit të administrimit qëndrojnë në detyrë për një periudhë kohore jo më të gjatë se tre vite ushtrimorë dhe largohen nga detyra në datën në të cilën mbahet Asambleja e thirrur për aprovimin e bilancit të vitit të fundit ushtrimor të qëndrimit të tyre në detyrë. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të rizgjidhen.</p> <p>4. Nëse gjatë vitit ushtrimor ndahen nga jeta një apo më shumë anëtarë të Këshillit të Administrimit, veprohet në bazë të nenit 2386 të Kodit Civil në përputhje me sa parashikuar nga paragrafi 1 lidhur me barazinë gjinore. dhe të përfaqësimit të punonjësve.</p> <p>5. Anëtarëve të këshillit të administrimit u njihen shpenzimet e përballuara prej tyre</p>	<p style="text-align: center;">KËSHILLI I ADMINISTRIMIT Neni 10 (Këshilli i Administrimit)</p> <p>1. Shoqëria administrohet nga një këshill administrimit i përbërë nga një minimum prej shtatë në një maksimum prej njëmbëdhjetë anëtarësh, edhe jo ortakë, të emëruar nga asambleja, e cila cakton numrin e tyre. Në çdo rast, të paktën dy të pestat e anëtarëve të këshillit të administrimit duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar duke e rrumbullakosur numrin në njësinë më të madhe.</p> <p>2. Asambleja e zakonshme, edhe gjatë mandatit, mund të ndryshojë numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit, gjithmonë brenda kufijve sipas paragrafit 1. Nëse asambleja do të rrisë numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit, këta të fundit do të qëndrojnë në detyrë deri në përfundimin e afatit të qëndrimit në detyrë të anëtarëve ekzistues të këshillit të administrimit.</p> <p>3. Anëtarët e këshillit të administrimit qëndrojnë në detyrë për një periudhë kohore jo më të gjatë se tre vite ushtrimorë dhe largohen nga detyra në datën në të cilën mbahet Asambleja e thirrur për aprovimin e bilancit të vitit të fundit ushtrimor të qëndrimit të tyre në detyrë. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të rizgjidhen.</p> <p>4. Nëse gjatë vitit ushtrimor ndahen nga jeta një apo më shumë anëtarë të Këshillit të Administrimit, veprohet në bazë të nenit 2386 të Kodit Civil në përputhje me sa parashikuar nga paragrafi 1 lidhur me barazinë gjinore.</p> <p>5. Anëtarëve të këshillit të administrimit u njihen shpenzimet e përballuara prej tyre</p>

gjatë ushtrimit të detyrës. Asambleja përcakton shumën e pagesës mbi bazë vjetore, për periudhën e qëndrimit në detyrë në bazë të nenit 2389, paragrafi 1, të kodit civil. Ndalohet gjithsesi të marrin pagesë për praninë e tyre në asamble.

6. Marrja e detyrës nga ana e anëtarit të këshillit të administrimit i nënshtrohet plotësimi të kushteve të listuara në vijim. Mospërmbushja e kushteve passjell largimin nga detyra. Ajo deklarohet nga këshilli i administrimit brenda tridhjetë ditësh nga emërimi ose nga marrja dijani e çështjes. Në mënyrë të veçantë:

6.1 Anëtarët e këshillit të administrimit duhet të zgjidhen në bazë të kriterëve të profesionalizmit dhe kompetencës ndër persona që kanë fituar një eksperiencë totale prej të paktën tre vitesh nëpërmjet ushtrimit të:

a) veprimtarive administruese ose kontrolli, pra, detyrave drejtuese pranë shoqërisë kapitale që operojnë në sektorë të ngjashëm me atë të veprimtarisë së shoqërisë ose të krahasueshme për nga përmasat dhe kompleksiteti, ose

b) veprimtari profesionale në fusha të lidhura me sektorin operativ të shoqërisë, ose

c) veprimtari profesionale në shoqëri që krahasohen për nga përmasat dhe kompleksiteti, ose

d) veprimtari mësimdhënieje universitare të lëndëve juridike, ekonomike ose lëndëve të cilat kanë lidhje me sektorin operativ të shoqërisë apo gjithsesi të lidhura me veprimtarinë sipërmarrëse, ose

e) funksione administrative ose drejtuese në ente publike apo administrata publike që operojnë në sektorë të lidhur me atë të veprimtarisë së shoqërisë, ose pranë enteve publike ose administratave publike që nuk kanë lidhje me sektorët e mësipërm, me kusht që funksionet të kenë të bëjnë me administrimin e burimeve ekonomiko-financiare.

6.2 Eksperiencat e fituara njëkohësisht në më shumë se një detyrë llogariten vetëm për periudhën kohore në të cilën janë fituar, pa i mbledhur ato.

6.3 Kryetari i këshillit të administrimit dhe

gjatë ushtrimit të detyrës. Asambleja përcakton shumën e pagesës mbi bazë vjetore, për periudhën e qëndrimit në detyrë në bazë të nenit 2389, paragrafi 1, të kodit civil. Ndalohet gjithsesi të marrin pagesë për praninë e tyre në asamble.

6. Marrja e detyrës nga ana e anëtarit të këshillit të administrimit i nënshtrohet plotësimi të kushteve të listuara në vijim. Mospërmbushja e kushteve passjell largimin nga detyra. Ajo deklarohet nga këshilli i administrimit brenda tridhjetë ditësh nga emërimi ose nga marrja dijani e çështjes. Në mënyrë të veçantë:

6.1 Anëtarët e këshillit të administrimit duhet të zgjidhen në bazë të kriterëve të profesionalizmit dhe kompetencës ndër persona që kanë fituar një eksperiencë totale prej të paktën tre vitesh nëpërmjet ushtrimit të:

a) veprimtarive administruese ose kontrolli, pra, detyrave drejtuese pranë shoqërisë kapitale që operojnë në sektorë të ngjashëm me atë të veprimtarisë së shoqërisë ose të krahasueshme për nga përmasat dhe kompleksiteti, ose

b) veprimtari profesionale në fusha të lidhura me sektorin operativ të shoqërisë, ose

c) veprimtari profesionale në shoqëri që krahasohen për nga përmasat dhe kompleksiteti, ose

d) veprimtari mësimdhënieje universitare të lëndëve juridike, ekonomike ose lëndëve të cilat kanë lidhje me sektorin operativ të shoqërisë apo gjithsesi të lidhura me veprimtarinë **sipërmarrëse**, ose

e) funksione administrative ose drejtuese në ente publike apo administrata publike që operojnë në sektorë të lidhur me atë të veprimtarisë së shoqërisë, ose pranë enteve publike ose administratave publike që nuk kanë lidhje me sektorët e mësipërm, me kusht që funksionet të kenë të bëjnë me administrimin e burimeve ekonomiko-financiare.

6.2 Eksperiencat e fituara njëkohësisht në më shumë se një detyrë llogariten vetëm për periudhën kohore në të cilën janë fituar, pa i mbledhur ato.

6.3 Kryetari i këshillit të administrimit dhe

administratori i deleguar duhet të kenë maturuar një eksperiencë totale prej të paktën pesë vitesh në veprimtaritë sipas paragrafëve të mësipërm.

6.4 Anëtarët e këshillit të administrimit të cilëve u janë dhënë në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të nenit 2381, paragrafi 2, të kodit civil, tagra administrimi pikërisht të këshillit të administrimit, mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit në jo më shumë se tre këshilla të tjerë në shoqëri aksionare. Me qëllim llogaritjen e këtyre afateve, nuk merren parasysh detyrat si anëtarë të këshillit të administrimit në shoqëri të kontrolluara apo të lidhura. Anëtarë të këshillit të administrimit të cilëve nuk u janë dhënë tagra si më sipër, mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit në jo më shumë se pesë këshilla të tjerë në shoqëri aksionare.

6.5 Nuk mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit dhe ata largohen automatikisht nga detyra me arsye pa të drejtën për t'u dëmshpërblyer, ata të cilët:

a) janë dënuar, edhe me vendim jo të formës së prerë, përveç efekteve të rehabilitimit, për një nga dënimet vijuese të parashikuara:

i) nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë bankare, financiare, atë të pasurive të luajtshme, në fushën e sigurisë dhe nga legjislacioni mbi tregjet dhe pasurive të luajtshme, të mjeteve të pagesës;

ii. nga titulli XI i librit V të kodit civil, nga vendimi Mbretëror nr. 267, datë 16 mars 1942 dhe nga dekreti legjislativ nr. 14, datë 12 janar 2019;

iii. nga legjislacioni që identifikon veprat penale ndaj administratës publike, kundër besimit publik, kundër pasurisë, kundër rendit publik, kundër ekonomisë publike, pra, në fushën e tatimeve;

iv. nga neni 51, paragrafi 3 bis, i kodit të procedurës penale si edhe nga neni 73 i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 309, datë 9 tetor 1990;

b) janë dënuar me vendim të formës së prerë, përveç efekteve të rehabilitimit, me jo më pak se dy vite burgim për çfarëdolloj vepre penale të kryer jo me dashje;

c) kanë qenë objekt të masave të sigurimit

administratori i deleguar duhet të kenë maturuar një eksperiencë totale prej të paktën pesë vitesh në veprimtaritë sipas paragrafëve të mësipërm.

6.4 Anëtarët e këshillit të administrimit të cilëve u janë dhënë në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të nenit 2381, paragrafi 2, të kodit civil, tagra administrimi pikërisht të këshillit të administrimit, mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit në jo më shumë se tre këshilla të tjerë në shoqëri aksionare. Me qëllim llogaritjen e këtyre afateve, nuk merren parasysh detyrat si anëtarë të këshillit të administrimit në shoqëri të kontrolluara apo të lidhura. Anëtarë të këshillit të administrimit të cilëve nuk u janë dhënë tagra si më sipër, mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit në jo më shumë se pesë këshilla të tjerë në shoqëri aksionare.

6.5 Nuk mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit dhe ata largohen automatikisht nga detyra me arsye pa të drejtën për t'u dëmshpërblyer, ata të cilët:

a) janë dënuar, edhe me vendim jo të formës së prerë, përveç efekteve të rehabilitimit, për një nga dënimet vijuese të parashikuara:

i) nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë bankare, financiare, atë të pasurive të luajtshme, në fushën e sigurisë dhe nga legjislacioni mbi tregjet dhe pasurive të luajtshme, të mjeteve të pagesës;

ii. nga titulli XI i librit V të kodit civil, nga vendimi Mbretëror nr. 267, datë 16 mars 1942 dhe nga dekreti legjislativ nr. 14, datë 12 janar 2019;

iii. nga legjislacioni që identifikon veprat penale ndaj administratës publike, kundër besimit publik, kundër pasurisë, kundër rendit publik, kundër ekonomisë publike, pra, në fushën e tatimeve;

iv. nga neni 51, paragrafi 3 bis, i kodit të procedurës penale si edhe nga neni 73 i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 309, datë 9 tetor 1990;

b) janë dënuar me vendim të formës së prerë, përveç efekteve të rehabilitimit, me jo më pak se dy vite burgim për çfarëdolloj vepre penale të kryer jo me dashje;

c) kanë qenë objekt të masave të sigurimit

të caktuara nga Autoriteti Gjyqësor në bazë të dekretit legjislativ nr. 159, datë 6 shtator 2011, përveç efekteve të rehabilitimit;

d) janë dënuar me vendim të formës së prerë me anë të së cilit është vërtetuar kryerja e një veprë penale me dashje ndaj tatimeve.

Përveç sa parashikuar më sipër, përbëjnë kushte për të mos u zgjedhur në detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit:

a) shpallja e vendimit të gjykimit ose e vendimit të gjykimit të menjëhershëm për secilën prej veprave penale sipas gërmës a) të kryeradhës së mësipërme, pa marrjen e një vendimi pafajësie qoftë edhe jo të formës së prerë;

b) dënimi me vendim jo të formës së prerë për secilën prej veprave penale sipas gërmës b) të kryeradhës së mësipërme;

c) aplikimi i përkohshëm i njërës prej masave të parashikuara nga neni 67, paragrafi 3, i dekretit legjislativ nr. 159, datë 6 shtator 2011;

d) aplikimi i një mase sigurimi personal.

Anëtari i këshillit të administrimit që gjatë mandatit të tij njoftohet për një nga masat si më sipër, duhet t'ia komunikojë menjëherë këtë fakt këshillit të administrimit, me detyrimin për ruajtjen e privatësisë. Këshilli i administrimit verifikon, në mbledhjen më të parë dhe, gjithsesi, brenda dhjetë ditëve pas marrjes dijeni të dhënies së masave si më sipër, ekzistencën e njërës prej kushteve të listuara këtu. Në rast se verifikimi jep rezultat pozitiv, anëtari i këshillit të administrimit largohet me arsye nga detyra, përveç rastit kur këshilli i administrimit, brenda afatit kohor prej dhjetë ditësh si më sipër, procedon me thirrjen e asamblesë e cila duhet të mbahet brenda gjashtëdhjetë ditëve të ardhshme, me qëllimin për t'i paraqitur kësaj të fundit propozimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të organit, duke arsyetuar këtë propozim në bazë të një interesi të madh të shoqërisë për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë administruese dhe në mungesë të ndikimit negativ mbi veprimtarinë dhe reputacionin e shoqërisë. Nëse verifikimi është kryer pas mbylljes së vitit ushtrimor, propozimi i bëhet asamblesë së thirrur për aprovimin e bilancit përkatës, duke iu përmbajtur afateve të

të caktuara nga Autoriteti Gjyqësor në bazë të dekretit legjislativ nr. 159, datë 6 shtator 2011, përveç efekteve të rehabilitimit;

d) janë dënuar me vendim të formës së prerë me anë të së cilit është vërtetuar kryerja e një veprë penale me dashje ndaj tatimeve.

Përveç sa parashikuar më sipër, përbëjnë kushte për të mos u zgjedhur në detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit:

a) shpallja e vendimit të gjykimit ose e vendimit të gjykimit të menjëhershëm për secilën prej veprave penale sipas gërmës a) të kryeradhës së mësipërme, pa marrjen e një vendimi pafajësie qoftë edhe jo të formës së prerë;

b) dënimi me vendim jo të formës së prerë për secilën prej veprave penale sipas gërmës b) të kryeradhës së mësipërme;

c) aplikimi i përkohshëm i njërës prej masave të parashikuara nga neni 67, paragrafi 3, i dekretit legjislativ nr. 159, datë 6 shtator 2011;

d) aplikimi i një mase sigurimi personal.

Anëtari i këshillit të administrimit që gjatë mandatit të tij njoftohet për një nga masat si më sipër, duhet t'ia komunikojë menjëherë këtë fakt këshillit të administrimit, me detyrimin për ruajtjen e privatësisë. Këshilli i administrimit verifikon, në mbledhjen më të parë dhe, gjithsesi, brenda dhjetë ditëve pas marrjes dijeni të dhënies së masave si më sipër, ekzistencën e njërës prej kushteve të listuara këtu. Në rast se verifikimi jep rezultat pozitiv, anëtari i këshillit të administrimit largohet me arsye nga detyra, përveç rastit kur këshilli i administrimit, brenda afatit kohor prej dhjetë ditësh si më sipër, procedon me thirrjen e asamblesë e cila duhet të mbahet brenda gjashtëdhjetë ditëve të ardhshme, me qëllimin për t'i paraqitur kësaj të fundit propozimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të organit, duke arsyetuar këtë propozim në bazë të një interesi të madh të shoqërisë për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë administruese dhe në mungesë të ndikimit negativ mbi veprimtarinë dhe reputacionin e shoqërisë. Nëse verifikimi është kryer pas mbylljes së vitit ushtrimor, propozimi i bëhet asamblesë së thirrur për aprovimin e bilancit përkatës, duke iu përmbajtur afateve të

parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në rast se asambleja nuk e aprovon propozimin e paraqitur nga këshilli i administrimit, apo në rast të një mungese përgjigjeje, anëtari i këshilli të administrimit largohet nga detyra me arsye me efekt të menjëhershëm, pa të drejtë dëmshpërblimi.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike 5, vendimi i aplikimit të dënimit në bazë të nenit 444 të kodit të procedurës penale është i barasvlershëm me vendimin e dënimit, përveç rastit të shuarjes së dënimit.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike 5, vendimet e marra nga autoritete të huaja, që përbëjnë shkaqe penguese, vlerësohen nga këshilli i administrimit në bazë të një gjykimi ekuivalence thelbësore me rastet e parashikuara e të rregulluara nga rregullorja e brendshme.

parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në rast se asambleja nuk e aprovon propozimin e paraqitur nga këshilli i administrimit, apo në rast të një mungese përgjigjeje, anëtari i këshilli të administrimit largohet nga detyra me arsye me efekt të menjëhershëm, pa të drejtë dëmshpërblimi.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike **6.5**, vendimi i aplikimit të dënimit në bazë të nenit 444 të kodit të procedurës penale është i barasvlershëm me vendimin e dënimit, përveç rastit të shuarjes së dënimit.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike **6.5**, vendimet e marra nga autoritete të huaja, që përbëjnë shkaqe penguese, vlerësohen nga këshilli i administrimit në bazë të një gjykimi ekuivalence thelbësore me rastet e parashikuara e të rregulluara nga rregullorja e brendshme.

STATUTI

i shoqërisë

Italia Trasporto Aereo S.p.A.

EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË – OBJEKTI

Neni 1

(Emërtimi)

1. Shoqëria aksionare e themeluar me vendim të Ministrit të ekonomisë dhe financave, së bashku me Ministrin e infrastrukturave e transporteve, Ministrin e zhvillimit ekonomik dhe Ministrin e punës dhe politikave sociale, në bazë të nenit 79 të Dekretit Legjislativ nr. 18, datë 17 mars 2020, i ndryshuar me anë të Ligjit nr. 27, datë 24 prill 2020, i ndryshuar nga neni 202 i Dekretit Legjislativ nr. 34, datë 19 maj 2020, i ndryshuar me anë të Ligjit nr. 77, datë 17 korrik 2020 dhe me nenin 87 të Dekretit Legjislativ nr. 104, datë 14 gusht 2020, është emërtuar "Italia Trasporto Aereo S.p.A." dhe rregullohet nga ky statut.
2. Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet në çdo formë grafike dhe me gërma të vogla dhe/ose të mëdha.

Neni 2

(Selia)

1. Shoqëria e ka selinë në Bashkinë e Roma-s.
2. Me vendim të Këshillit të administrimit mund të hapen apo mbyllen, në format e parashikuara me ligj, seli dytësore, filiale, degë, agjenci dhe zyra në Itali dhe jashtë saj.


Neni 3

(Objekti)

1. Shoqëria, që operon nën regjimin e së drejtës private, duke ndjekur objektiva të natyrës tregtare dhe industriale në përputhje me rregulloren e brendshme dhe atë të Bashkimit Evropian, përveç sa parashikuar nga paragrafët 3 dhe 4-bis të nenit 79 të Ligjit nr. 18, datë 17 mars 2020, i ndryshuar e i plotësuar, ka për objekt ushtrimin e veprimtarisë sipërmarrëse në sektorin e transportit ajror të njerëzve dhe mallrave, kundrejt ndërtimit dhe aprovimit të planit industrial të zhvillimit dhe zgjerimit të ofertës që përfshin strategji strukturore të produktit në bazë të paragrafit 4-bis si më sipër.

Për realizimin e objektit të shoqërisë, shoqëria vepron nëpërmjet:

- a) përdorimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose nëpërmjet shoqërive në të cilat ka pjesëmarrje dhe/ose enteve dhe/ose konsorciumeve, linjave dhe lidhjeve ajrore për transportin e njerëzve dhe sendeve në Itali, midis Italisë dhe Vendeve të huaja dhe në Vende të huaja, përfshirë këtu promovimin, vënien në jetë dhe administrimin e nismave e shërbimeve në fushën e transportit ajror;
- b) kryerjes, drejtpërdrejt apo jo, në Itali e në Vende të huaja, të veprimtarive të riparimit apo të mirëmbajtjes së avionëve, të qiradhënies/qiramarrjes dhe të asistencës dhënë të tretëve, të "ground-handling", si edhe të veprimtarive ajrore-didaktike, shërbimeve dhe punimeve në avionë në përgjithësi, pa asnjë përjashtim;
- c) kryerjes së çdo veprimtarie tjetër ndihmëse, plotësuese e të lidhur me veprimtaritë e sipërpërmendura.



2. Përbushja e objektit të shoqërisë mund të arrihet edhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara apo atyre në të cilat Shoqëria ka pjesëmarrje, për administrimin e degëve të veçanta dhe për zhvillimin e sinergjive e aleancave me subjekte të tjerë publikë e privatë, italianë e të huaj. Shoqëria autorizohet, gjithashtu, të blejë dhe marrë me qira, edhe nëpërmjet marrëveshjeve të drejtpërdrejta, degë shoqërisht të subjekteve të pajisura me leje të transportit ajror të lëshuara nga Enti Kombëtar për Aviacionin Civil, edhe nën administrim të jashtëzakonshëm.

3. Shoqëria do të mundë të kryejë të gjitha veprimet që do të vlerësojë se janë të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimit të saj, edhe nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta dhe, për këtë, qëllim, do të mundë, kryesisht, por pa u kufizuar vetëm në to:

a) të kryejë veprime në fushën e pasurive të paluajtshme, atyre të luajtshme, veprimet tregtare, industriale, financiare - përfshirë këtu dhënien e garancive në favor të shoqërive të cilat i përkasin të njëjtit grup - hipotekore dhe të shitjes së shërbimeve gjithsesi të lidhura me objektin e shoqërisë;

b) të ketë pjesëmarrje, në mbështetje të veprimtarive që përbëjnë objektin e shoqërisë dhe jo me qëllim pozicionimi, pjesëmarrje, kuota apo dividend në shoqëri të tjera, konsorciume, sipërmarrje apo ente të çfarëdo natyre, si italiane ashtu edhe të huaja – të cilat rezultojnë të jenë në gjendje të qëndrueshme financiare, pasurore dhe ekonomike dhe me perspektivë për të prodhuar të ardhura;

c) të marrë pjesë në tendera publikë si edhe të lidhë me Shtetin Italian marrëveshje me qëllim kryerjen e shërbimeve publike;

d) të zhvillojë sinergji e aleanca me subjekte të tjerë publikë e privatë, italianë e të huaj, si edhe të lidhë çdo lloj marrëveshjeje me të tretë, përfshirë këtu Shtete të huaja, për zhvillimin e veprimtarisë së transportit ajror edhe jashtë territorit italian.

Neni 4

(Kohëzgjatja e veprimtarisë)

Data e fundit në të cilën shoqëria do të ushtrojë veprimtari është data 31 dhjetor 2100 përveç rastit të mbylljes së parakohshme të veprimtarisë së saj apo shtyrjes së mundshme të afatit, e vendosur nga Asambleja e jashtëzakonshme.

KAPITALI – AKSIONE

Neni 5

(Kapitali)

1. Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 20.000.000,00 Euro (njëzetë milionë euro e zero qindarka) i ndarë në nr. 20.000 (njëzetë mijë) aksione të zakonshme pa vlerë nominale.

2. Kapitali i shoqërisë mund të rritet edhe nëpërmjet kontributit në natyrë dhe kreditimeve.

Neni 6

(Aksione)

1. Aksionet janë të regjistruara dhe i japin titullarit të tyre të drejta të barabarta. Aksionet përbëhen nga tituj aksionesh të nënshkruara nga njëri prej anëtarëve të këshillit të administrimit.

2. Çdo aksion të jep të drejtën e një vote.

3. Aksionet janë të pandashme. Në rast bashkëpronësie aplikohen dispozitat e parashikuara nga neni 2347 i kodit civil.

4. Mbajtja e qoftë edhe vetëm një aksioni përbën në vetvete aderimin në këtë statut.

5. Secili prej aksionerëve i komunikon shoqërisë çdo informacion që këshilli i administrimit mund, herë pas here, të kërkojë lidhur me kombësinë dhe/ose kombësinë e ortakëve të vetë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë dhe/ose mbajtësve të të drejtave të tjera mbi kapitalin e shoqërisë në mënyrë që të lejojë këshillin e administrimit të verifikojë, herë pas here, përmbushjen e sa parashikuar nga rregulloret mbi kombësinë të parashikuara nga Rregullorja (BE) Nr. 1008/2008. Këshilli i administrimit bën, në bazë të sa rezulton nga regjistri i ortakëve, përditësimin e informacioneve mbi përbërjen e aksioneve në statut, përfshirë atë lidhur me kombësinë e titullarëve të aksioneve dhe/ose të ortakëve të tyre sipas kryeradhës së mësipërme.

Neni 7

(Tituj debitimi dhe mjete financiare pjesëmarrëse)

Asambleja e jashtëzakonshme mund të vendosë, me mënyrat e rregulluara me ligj, nxjerrjen e obligacioneve, edhe të konvertueshme, apo mjeteve të tjera financiare, përfshirë këtu mjete financiare pjesëmarrëse.

ASAMBLEJA

Neni 8

(Thirrje e asamblesë)

1. Asambleja, si ajo e zakonshme ashtu edhe e ajo jashtëzakonshme, mblidhet nga organi administrativ, edhe jashtë selisë së shoqërisë, me kusht që të mblidhet brenda territorit italian, dhe pjesëmarrësit në të njoftohen me letër rekomande apo postë elektronike me provë të marrjes së njoftimit të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së caktuar për mbajtjen e Asamblesë. Ky afat, në rast urgjence, mund të ulet në 8 (tetë) ditë.
2. Njoftimi i thirrjes duhet të përmbajë vendin, ditën dhe orën e mbledhjes dhe listën e çështjeve për t'u trajtuar, si edhe mund të përmbajë një datë tjetër për thirrjen e dytë.
3. Asambleja, si e zakonshme ashtu edhe e jashtëzakonshme, quhet e thirrur në mënyrë të vlefshme, edhe në mungesë të formalizmave si më sipër të thirrjes së saj, me kusht që të përmbushen kushtet e parashikuara nga neni 2366, paragrafi i katërt, i kodit civil. Në këtë rast duhet t'u komunikohen në mënyrë të menjëhershme vendimet e marra anëtarëve të këshillit të administrimit dhe Bordit auditues që nuk janë të pranishëm gjatë zhvillimit të asamblesë.
4. Asambleja, si e zakonshme ashtu edhe e jashtëzakonshme, mund të mbahet edhe me të pranishmit të vendosur në disa vende të ndodhura afër apo larg, të cilët janë të lidhur me sistem video-audio me njëri-tjetrin, me kusht që të respektohet mënyra kolegjiale dhe që:
 - a) t'i lejohet Kryetarit të asamblesë të kryejë funksionet e tij;
 - b) t'i lejohet mbajtësit të proces-verbalit të kuptojë siç duhet zhvillimet e asamblesë, objekt proces-verbali;
 - c) t'u lejohet pjesëmarrësve në asamble të marrin pjesë në kohë reale në diskutime dhe njëherazi të votojnë çështjet në rend të ditës, si edhe të dërgojnë, marrin e konsultojnë dokumenta.
5. Asambleja e jashtëzakonshme duhet të thirret në rastet dhe për çështjet e parashikuara nga ligji dhe nga ky Statut.
6. Asambleja e zakonshme duhet të thirret nga këshilli i administrimit të paktën një herë në vit në përputhje me sa parashikuar nga neni 2364 i kodit civil.
7. Këshilli i administrimit ka detyrimin të thërrasë asamblenë e Ortakëve, çdo herë që kërkohet nga aq ortakë sa të përfaqësohet të paktën një e dhjeta e kapitalit të shoqërisë. Mbledhja duhet të caktohet brenda një afati prej tridhjetë ditësh nga kërkesa përkatëse.

8. Asambleja e thirrur në formë të rregullt përfaqëson tërësinë e ortakëve dhe vendimet që merren nga ajo, në përputhje me këtë Statut dhe në bazë të ligjit, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët edhe për ata që mund të mos kenë qenë të pranishëm apo mund të mos kenë qenë dakord, si edhe për përfutuesit e të drejtave, përveç sa parashikuar nga neni 2437 i kodit civil.

Neni 9

(Kryetari i asamblesë dhe vendimet që merren gjatë asamblesë)

1. Asambleja drejtohet nga Kryetari i këshillit të administrimit ose, në mungesë të tij, nga personi i zgjedhur nga shumica e pjesëmarrësve në Asamble. Asambleja emëron Sekretarin, edhe jo ortak.
2. Drejtuesi i asamblesë verifikon nëse asambleja është mbledhur në mënyrë të rregullt, sigurohet për identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, rregullon zhvillimin e punimeve të asamblesë dhe vërteton rezultatet e votimeve.
3. Për të gjitha vendimet e asamblesë mbahet proces-verbal i cili duhet të nënshkruhet nga Kryetari dhe nga Sekretari, përveç rastit kur proces-verbali mbahet nga një noter.
4. Çdo ortak mund të përfaqësohet në asamble sipas sa parashikuar nga neni 2372 i kodit civil.
5. Asambletë e zakonshme e të jashtëzakonshme, si në thirrjen e parë ashtu edhe në thirrjen e dytë, vendosin me shumicat në bazë të ligjit.
6. Sekretari mund të lëshojë kopje apo ekstrakte të proces-verbaleve të asambleve.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

Neni 10

(Këshilli i administrimit)

1. Shoqëria administrohet nga një këshill administrimit i përbërë nga një minimum prej shtatë në një maksimum prej njëmbëdhjetë anëtarësh, edhe jo ortakë, të emëruar nga asambleja, e cila cakton numrin e tyre. Në çdo rast, të paktën dy të pestat e anëtarëve të këshillit të administrimit duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar duke e rrumbullakosur numrin në njësinë më të madhe.
2. Asambleja e zakonshme, edhe gjatë mandatit, mund të ndryshojë numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit, gjithmonë brenda kufijve sipas paragrafit 1. Nëse asambleja do të rrisë numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit, këta të fundit do të qëndrojnë në detyrë deri në përfundimin e afatit të qëndrimit në detyrë të anëtarëve ekzistues të këshillit të administrimit.
3. Anëtarët e këshillit të administrimit qëndrojnë në detyrë për një periudhë kohore jo më të gjatë se tre vite ushtrimorë dhe largohen nga detyra në datën në të cilën mbahet Asambleja e thirrur për aprovimin e bilancit të vitit të fundit ushtrimor të qëndrimit të tyre në detyrë. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të rizgjidhen.
4. Nëse gjatë vitit ushtrimor ndahen nga jeta një apo më shumë anëtarë të Këshillit të Administrimit, veprohet në bazë të nenit 2386 të Kodit Civil në përputhje me sa parashikuar nga paragrafi 1 lidhur me barazinë gjinore.
5. Anëtarëve të këshillit të administrimit u njihen shpenzimet e përballuara prej tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Asambleja përcakton shumën e pagesës mbi bazë vjetore, për periudhën e qëndrimit në detyrë në bazë të nenit 2389, paragrafi 1, të kodit civil. Ndalohet gjithsesi të marrin pagesë për praninë e tyre në asamble.
6. Marrja e detyrës nga ana e anëtarit të këshillit të administrimit i nënshtrohet plotësisht të kushteve të listuara në vijim. Mospërbushja e kushteve passjell largimin nga detyra. Ajo deklarohet nga këshilli i administrimit brenda tridhjetë ditësh nga emërimi ose nga marrja dijani e çështjes. Në mënyrë të veçantë:

M

6.1 Anëtarët e këshillit të administrimit duhet të zgjidhen në bazë të kriterëve të profesionalizmit dhe kompetencës ndër persona që kanë fituar një eksperiencë totale prej të paktën tre vitesh nëpërmjet ushtrimit të:

a) veprimtarive administruese ose kontrolli, pra, detyrave drejtuese pranë shoqërisë kapitale që operojnë në sektorë të ngjashëm me atë të veprimtarisë së shoqërisë ose të krahasueshme për nga përmasat dhe kompleksiteti, ose

b) veprimtari profesionale në fusha të lidhura me sektorin operativ të shoqërisë, ose

c) veprimtari profesionale në shoqëri që krahasohen për nga përmasat dhe kompleksiteti, ose

d) veprimtari mësimdhënieje universitare të lëndëve juridike, ekonomike ose lëndëve të cilat kanë lidhje me sektorin operativ të shoqërisë apo gjithësesi të lidhura me veprimtarinë sipërmarrëse, ose

e) funksione administrative ose drejtuese në ente publike apo administrata publike që operojnë në sektorë të lidhur me atë të veprimtarisë së shoqërisë, ose pranë enteve publike ose administratave publike që nuk kanë lidhje me sektorët e mësipërm, me kusht që funksionet të kenë të bëjnë me administrimin e burimeve ekonomiko-financiare.

6.2 Eksperiencat e fituara njëkohësisht në më shumë se një detyrë llogariten vetëm për periudhën kohore në të cilën janë fituar, pa i mbledhur ato.

6.3 Kryetari i këshillit të administrimit dhe administratori i deleguar duhet të kenë maturuar një eksperiencë totale prej të paktën pesë vitesh në veprimtaritë sipas paragrafëve të mësipërm.

6.4 Anëtarët e këshillit të administrimit të cilëve u janë dhënë në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të nenit 2381, paragrafi 2, të kodit civil, tagra administrimi pikërisht të këshillit të administrimit, mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit në jo më shumë se tre këshilla të tjerë në shoqëri aksionare. Me qëllim llogaritjen e këtyre afateve, nuk merren parasysh detyrat si anëtarë të këshillit të administrimit në shoqëri të kontrolluara apo të lidhura. Anëtarë të këshillit të administrimit të cilëve nuk u janë dhënë tagra si më sipër, mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit në jo më shumë se pesë këshilla të tjerë në shoqëri aksionare.

6.5 Nuk mund të marrin detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit dhe ata largohen automatikisht nga detyra me arsye pa të drejtën për t'u dëmshpërblyer, ata të cilët:

a) janë dënuar, edhe me vendim jo të formës së prerë, përveç efekteve të rehabilitimit, për një nga dënimet vijuese të parashikuara:

i) nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë bankare, financiare, atë të pasurive të luajtshme, në fushën e sigurisë dhe nga legjislacioni mbi tregjet dhe pasurive të luajtshme, të mjeteve të pagesës;

ii. nga titulli XI i librit V të kodit civil, nga vendimi Mbretëror nr. 267, datë 16 mars 1942 dhe nga dekreti legjislativ nr. 14, datë 12 janar 2019;

iii. nga legjislacioni që identifikon veprat penale ndaj administratës publike, kundër besimit publik, kundër pasurisë, kundër rendit publik, kundër ekonomisë publike, pra, në fushën e tatimeve;


iv. nga neni 51, paragrafi 3 bis, i kodit të procedurës penale si edhe nga neni 73 i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 309, datë 9 tetor 1990;

b) janë dënuar me vendim të formës së prerë, përveç efekteve të rehabilitimit, me jo më pak se dy vite burgim për çfarëdolloj vepra penale të kryer jo me dashje;

c) kanë qenë objekt të masave të sigurimit të caktuara nga Autoriteti Gjyqësor në bazë të dekretit legjislativ nr. 159, datë 6 shtator 2011, përveç efekteve të rehabilitimit;

d) janë dënuar me vendim të formës së prerë me anë të së cilit është vërtetuar kryerja e një vepra penale me dashje ndaj tatimeve.

Përveç sa parashikuar më sipër, përbëjnë kushte për të mos u zgjedhur në detyrën e anëtarit të këshillit të administrimit:

- 
- a) shpallja e vendimit të gjykimit ose e vendimit të gjykimit të menjëhershëm për secilën prej veprave penale sipas gërmës a) të kryeradhës së mësipërme, pa marrjen e një vendimi pafajësie qoftë edhe jo të formës së prerë;
 - b) dënimi me vendim jo të formës së prerë për secilën prej veprave penale sipas gërmës b) të kryeradhës së mësipërme;
 - c) aplikimi i përkohshëm i njëres prej masave të parashikuara nga neni 67, paragrafi 3, i dekretit legjislativ nr. 159, datë 6 shtator 2011;
 - d) aplikimi i një mase sigurimi personal.

Anëtari i këshillit të administrimit që gjatë mandatit të tij njoftohet për një nga masat si më sipër, duhet t'ia komunikojë menjëherë këtë fakt këshillit të administrimit, me detyrimin për ruajtjen e privatësisë. Këshilli i administrimit verifikon, në mbledhjen më të parë dhe, gjithsesi, brenda dhjetë ditëve pas marrjes dijeni të dhënies së masave si më sipër, ekzistencën e njërit prej kushteve të listuara këtu. Në rast se verifikimi jep rezultat pozitiv, anëtari i këshillit të administrimit largohet me arsye nga detyra, përveç rastit kur këshilli i administrimit, brenda afatit kohor prej dhjetë ditësh si më sipër, procedon me thirrjen e asamblesë e cila duhet të mbahet brenda gjashtëdhjetë ditëve të ardhshme, me qëllimin për t'i paraqitur kësaj të fundit propozimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të organit, duke arsyetuar këtë propozim në bazë të një interesi të madh të shoqërisë për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë administruese dhe në mungesë të ndikimit negativ mbi veprimtarinë dhe reputacionin e shoqërisë. Nëse verifikimi është kryer pas mbylljes së vitit ushtrimor, propozimi i bëhet asamblesë së thirrur për aprovimin e bilancit përkatës, duke iu përmbajtur afateve të parashikuara nga legjislati në fuqi. Në rast se asambleja nuk e aprovon propozimin e paraqitur nga këshilli i administrimit, apo në rast të një mungese përgjigjeje, anëtari i këshillit të administrimit largohet nga detyra me arsye me efekt të menjëhershëm, pa të drejtë dëmshpërblimi.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike 6.5, vendimi i aplikimit të dënimit në bazë të nenit 444 të kodit të procedurës penale është i barasvlershëm me vendimin e dënimit, përveç rastit të shuarjes së dënimit.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike 6.5, vendimet e marra nga autoritete të huaja, që përbëjnë shkaqe penguese, vlerësohen nga këshilli i administrimit në bazë të një gjykimi ekuivalence thelbësore me rastet e parashikuara e të rregulluara nga rregullorja e brendshme.

Neni 11 (Administrimi i shoqërisë)

1. Këshilli, nëse nuk është zgjedhur në asamble, zgjedh, ndër anëtarët e tij, Kryetarin, në bazë të nenit 2380 bis të kodit civil.
2. Kryetari:
 - a) ka tagrin të përfaqësorë shoqërinë;
 - b) drejton asamblenë e ortakëve;
 - c) thërret dhe drejton këshillin e administrimit;
 - d) cakton rendin e ditës së punimeve të këshillit, koordinon këto punime dhe kujdeset që të gjithë anëtarëve të këshillit të administrimit dhe anëtarëve të Bordit të Auditimit t'u jepen informacionet e duhura mbi çështjet e vendosura në rend të ditës.
3. Këshilli mbledhet në vendin e caktuar sipas njoftimit të thirrjes të paktën çdo dy muaj dhe, gjithsesi, çdo herë që të vlerësohet e nevojshme nga Kryetari apo kur paraqitet kërkesë e arsyetuar me shkrim nga shumica e anëtarëve të tij ose Bordi i Auditimit.
4. Thirrja e asamblesë bëhet me letër rekomande apo postë elektronike me provë për marrjen e njoftimit, përmban rendin e ditës, për t'u dërguar të paktën pesë ditë para datës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes dhe, në raste urgjente, me postë elektronike me provë për marrjen e njoftimit për t'u dërguar të paktën dy ditë para në adresën për marrjen e njoftimeve të secilit anëtar të këshillit të administrimit dhe të secilit Anëtar efektiv të Bordit

M

të Auditimit. Mbledhjet e këshillit të administrimit drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga anëtari më i moshuar të njëjtit këshill.

6. Mbledhjet mund të zhvillohet në konferencë video apo tele-konferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit në to të mund të identifikohen në çdo moment të lidhjes dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin, të marrin, dërgojnë dhe/ose konsultojnë dokumenta, të ndërhyjnë në diskutim dhe në kohë reale mbi të gjitha çështjet e vendosura në rend të ditës, si edhe të vendosin në tërësi.

7. Për vlefshmërinë e mbledhjeve të këshillit është e nevojshme prania e shumicës së anëtarëve në detyrë të këshillit të administrimit. Vendimet merren me shumicë absolute të votave të së pranishmëve. Në rast balotazhi vlen vota e drejtuesit të mbledhjes.

8. Vendimet e këshillit të administrimit rezultojnë nga proces-verbale që, të transkriptuar në një regjistër të veçantë të mbajtur sipas ligjit, nënshkruhen nga Presidenti apo ai që e zëvendëson në këtë detyrë dhe nga sekretari. Sekretari mund të lëshojë kopje e ekstrakte të proces-verbaleve të mbledhjeve të këshillit të administrimit.

9. Administrimi i shoqërisë i takon ekskluzivisht këshillit të administrimit, i cili kryen veprimet e nevojshme për zbatimin e objektit të shoqërisë.

10. Këshilli i administrimit ka gjithashtu tagrat në situatat si vijon:

a) bashkim me përthithje me shoqëri në të cilat të paktën 90% e aksioneve apo kuotave janë në pronësi të shoqërisë;

b) ndarje pjesore në favor të shoqërisë në të cilën të paktën 90% e aksioneve apo kuotave janë në pronësi të shoqërisë;

c) hapje dhe mbyllje të selive dytësore;

d) përshtatje e statutit me legjislacionin;

Asambleja ka gjithmonë të drejtë të vendosë mbi çështjet si më sipër.

11. Këshilli i Administrimit, me vendim të asamblesë, mund t'i japë tagra operative Kryetarit mbi çështjet që mund t'i delegohen atij në bazë të ligjit. Këshilli i Administrimit mund të delegojë kompetencat e veta, në përputhje me kufizimet e përcaktuara nga neni 2381 i kodit civil, njërit apo më shumë anëtarëve të tij. Këshilli, me propozim të Kryetarit, në marrëveshje me administratorin e deleguar, mund të autorizojë gjithashtu për kryerje të veprimeve të veçanta edhe anëtarë të tjerë të Këshillit të Administrimit. Administratori i deleguar, në kufijtë e tagrave që i janë dhënë, mund të autorizojë e të japë tagra përfaqësimi të shoqërisë për kryerjen e veprimeve të veçanta apo disa kategorive të veprimeve, punonjësve të shoqërisë por edhe të tretëve.

12. Këshilli i administrimit mund të emërojë komitete brenda këshillit duke përcaktuar numrin e anëtarëve të tyre, rregullat e funksionimit dhe pagesat për këta anëtarë. Këshilli i administrimit, me propozim të përbashkët të Kryetarit dhe të Administratorit të Deleguar, promovon themelimin e një organizmi të përbashkët të përbërë nga një apo më shumë anëtarë të vetë këshillit dhe nga një anëtar për secilën prej Organizatave Kombëtare të Sindikatave që lidhin kontratën përkatëse kolektive kombëtare të punës, si edhe, të integruar nga themelimi i tyre, nga anëtarët e Përfaqësisë së Sindikatës, me qëllim konsultimin paraprak mbi linjat strategjike të shoqërisë që kanë ndikim domethënës mbi kushtet e punës, mbi punësimin dhe mbi zhvillimin e shoqërisë.

Neni 12

(Përfaqësimi i shoqërisë)

1. Përfaqësimi i shoqërisë, përballë çdo autoriteti gjyqësor apo administrativ si edhe të tretëve, si edhe firma në emër të shoqërisë, i takojnë si Kryetarit të Këshillit të Administrimit ashtu edhe administratorit të deleguar, në formë të pavarur nga njëri-tjetri.

2. Kryetari i Këshillit të Administrimit dhe administratori i deleguar mund të emërojnë, në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, avokatë e përfaqësues që përfaqësojnë në gjykim shoqërinë.

3. Kryetari i këshillit të administrimit dhe administratori i deleguar mund të emërojnë, në formë të pavarur nga njëri-tjetri dhe brenda kufijve të tagrave që u janë dhënë atyre vetë, përfaqësues të posaçëm për kryerjen e veprimeve të veçanta apo disa kategorive të veprimeve. Përfaqësimi i shoqërisë u takon gjithashtu atyre subjekteve të cilëve ky tagër u është dhënë dhe në kufijtë e këtyre tagrave të dhëna.

BORDI I AUDITUESVE LIGJORË – AUDITIMI LIGJOR I LLOGARIVE

Neni 13 (Audituesit)

1. Asambleja emëron Bordin e Audituesve ligjorë të përbërë nga tre anëtarë efektivë, nga të cilët zgjedh Kryetarin dhe përcakton pagesën për të. Asambleja emëron gjithashtu dy anëtarë bordi të përkohshëm. Anëtarët e përhershëm e të përkohshëm duhet të zgjidhen ndër audituesit ligjorë të regjistruar në regjistrin përkatës. Një anëtar efektiv bordi dhe një anëtar zëvendësues duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar. Nëse gjatë mandatit ndahet nga jeta një apo më shumë Anëtarë efektivë, marrin detyrën anëtarët zëvendësues duke iu përmbajtur rendit që garanton respektimin e rregulloreve si më sipër lidhur me barazinë gjinore. Anëtarëve të Bordit të Auditimit u njihen shpenzimet që përballojnë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Ndalohet gjithsesi të paguhet për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e bordit.

2. Anëtarët e Bordit të Auditimit qëndrojnë në detyrë përgjatë tre viteve ushtrimorë dhe largohen nga detyra në datën në të cilën mbahet asambleja e thirrur për aprovimin e bilancit të vitit të tretë ushtrimor gjatë detyrës së tyre dhe mund të rizgjidhen. Largimi, zëvendësimi dhe pushimi nga detyra i anëtarëve të Bordit të Auditimit rregullohen nga legjislacioni në fuqi.

3. Anëtarët e Bordit të Auditimit duhet të zgjidhen sipas kriterëve të profesionalizmit dhe aftësisë, ndër personat që kanë fituar një eksperiencë në total, prej të paktën një tre-vjeçari, në ushtrimin e veprimtarive të parashikuara nga neni 2397 i kodit civil. Kryetari i Bordit të Auditimit duhet të ketë fituar të paktën një eksperiencë pesë-vjeçare në të njëjtat veprimtari.

4. Nuk mund të mbajnë detyrën e anëtarit të Bordit të Auditimit ata të cilët gjatë mandatit të mëparshëm kanë qenë anëtarë të këshillit të administrimit të shoqërisë apo të shoqërive të kontrolluara.

5. Nuk mund të mbajnë detyrën e anëtarit të Bordit të Auditimit, gjë që çon në largimin e menjëhershëm me arsye të tyre nga detyra, pa të drejtë dëmshpërblimi, ata të cilët:

a) janë dënuar, edhe me vendim jo të formës së prerë, përveç efekteve të rehabilitimit, për një nga dënimet vijuese të parashikuara:

i. nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë bankare, financiare, atë të pasurive të luajtshme, në fushën e sigurisë dhe nga legjislacioni mbi tregjet dhe vlerat e tundshme, të mjeteve të pagesës;

ii. nga titulli XI i librit V të kodit civil, nga vendimi Mbretëror nr. 267, datë 16 mars 1942 dhe nga dekreti legjislativ nr. 14, datë 12 janar 2019;

iii. nga legjislacioni që identifikon veprat penale ndaj administratës publike, kundër besimit publik, kundër pasurisë, kundër rendit publik, kundër ekonomisë publike, pra, në fushën e tatimeve;

iv. nga neni 51, paragrafi 3 bis, i kodit të procedurës penale si edhe nga neni 73 i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 309, datë 9 tetor 1990;

b) janë dënuar me vendim të formës së prerë, përveç efekteve të rehabilitimit, me jo më pak se dy vite burgim për çdo vepër penale të kryer jo me dashje;

c) u janë nënshtruar masave të sigurimit të caktuara nga Autoriteti Gjyqësor në bazë të dekretit legjislativ nr. 159, datë 6 shtator 2011, përveç efekteve të rehabilitimit;

d) janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje ndaj tatimeve.

Përveç sa parashikuar më sipër, përbëjnë kushte për të mos u zgjedhur në detyrën e anëtarit të Bordit të Auditimit:

a) shpallja e vendimit të gjykimit ose e vendimit të gjykimit të menjëhershëm për secilën prej veprave penale sipas gërmës a) të kryeradhës së mësipërme, pa marrjen e një vendimi pafajësie qoftë edhe jo të formës së prerë;

b) dënimi me vendim jo të formës së prerë për secilën prej veprave penale sipas gërmës b) të kryeradhës së mësipërme;

c) aplikimi i përkohshëm i njërës prej masave të parashikuara nga neni 67, paragrafi 3, i dekretit legjislativ nr. 159, datë 6 shtator 2011;

d) aplikimi i një mase sigurimi personal.

Anëtari i Bordit të Auditimit që gjatë mandatit të tij njoftohet për një nga masat si më sipër, duhet t'ia komunikojë menjëherë këtë fakt këshillit të administrimit, me detyrimin për ruajtjen e privatësisë. Bordi i Auditimit verifikon, në mbledhjen më të parë dhe, gjithsesi, brenda dhjetë ditëve pas marrjes dijeni të dhënies së masave si më sipër, ekzistencën e njërës prej kushteve të listuara këtu. Në rast se verifikimi jep rezultat pozitiv, anëtari i Bordit të Auditimit largohet me arsye nga detyra, përveç rastit kur këshilli i administrimit, brenda afatit kohor prej dhjetë ditësh si më sipër, procedon me thirrjen e asamblesë e cila duhet të mbahet brenda gjashtëdhjetë ditëve të ardhshme, me qëllimin për t'i paraqitur kësaj të fundit propozimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të organit, duke arsyetuar këtë propozim në bazë të një interesi të madh të shoqërisë për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë administruese dhe në mungesë të ndikimit negativ mbi veprimtarinë dhe reputacionin e shoqërisë. Nëse verifikimi është kryer pas mbylljes së vitit ushtrimor, propozimi i bëhet asamblesë së thirrur për aprovimin e bilancit përkatës, duke iu përmbajtur afateve të parashikuara nga legjislati në fuqi. Në rast se asambleja nuk e aprovon propozimin e paraqitur nga këshilli i administrimit, apo në rast të një mungese përgjigjeje, anëtari i Bordit të Auditimit largohet nga detyra me arsye me efekt të menjëhershëm, pa të drejtë dëmshpërblimi.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike, vendimi i aplikimit të dënimit në bazë të nenit 444 të kodit të procedurës penale është i barasvlershëm me vendimin e dënimit, përveç rastit të shuarjes së dënimit.

Me qëllim aplikimin e kësaj pike, vendimet e marra nga autoritete të huaja, që përbëjnë shkaqe penguese, vlerësohen nga këshilli i administrimit në bazë të një gjykimi ekuivalence thelbësore me rastet e parashikuara e të rregulluara nga rregullorja e brendshme.

6. Bordi i Auditimit mbikëqyr respektimin e ligjit e të Statutit, respektimin e parimeve të administrimit korrekt dhe, në mënyrë të veçantë, përshtatshmërinë e strukturës organizative, administrative e kontabël të Shoqërisë dhe funksionimin e saj konkret. Bordi i Auditimit mund t'u kërkojë administratorëve informacion mbi ecurinë e veprimtarive të shoqërisë dhe mbi sipërmarrje të veçanta.

7. Bordi i Auditimit duhet të mblidhet të paktën një herë në nëntëdhjetë ditë. Mbledhjet mund të zhvillohen edhe nëpërmjet sistemeve audio-vizive dhe telekonferencave apo sistemeve të ngjashme të komunikimit në distancë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të diskutojnë në kohë reale gjatë trajtimit të çështjeve përkatëse si edhe të marrin e dërgojnë dokumentacion.

Neni 14 (Auditimi ligjor i llogarive)

Auditimi ligjor i llogarive kryhet nga një shoqëri auditimi e regjistruar në regjistrin përkatës. Detyra jepet nga asambleja, kundrejt propozimit të arsyetuar të Bordit të Auditimit për një afat prej tre vitesh ushtrimorë dhe përfundon në datën në të cilën mbahet asambleja e

thirrur për aprovimin e bilancit të vitit të tretë ushtrimor të detyrës. Shoqëria audituese dokumenton veprimtarinë e kryer në një regjistër të veçantë të mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

Neni 15
(Drejtuesi Mbikëqyrës)

1. Këshilli i administrimit emëron, me propozim të administratorit të deleguar, kundrejt opinionin të detyrueshëm të vetë Bordit të Auditimit, për një periudhë jo më të shkurtër se ajo e qëndrimit në detyrë të vetë Bordit dhe jo më të gjatë se gjashtë vite ushtrimorë, drejtuesin e ngarkuar me mbajtjen e dokumentave kontabël të shoqërisë për kryerjen e detyrave të dhëna atij në bazë të nenit 154-bis të Dekretit Legjislativ nr. 58, datë 24 shkurt 1998, i ndryshuar.
2. Drejtuesi i ngarkuar me mbajtjen e dokumentave kontabël të shoqërisë duhet të plotësojë kushtet e përshtatshmërisë të parashikuara për anëtarët e këshillit të administrimit.
3. Drejtuesi i ngarkuar me mbajtjen e dokumentave kontabël të shoqërisë duhet të zgjidhet, në bazë të kriterëve të profesionalizmit dhe kompetencës, nga radhët e drejtuesve të cilët kanë fituar një eksperiencë në total jo më të vogël se tre vite në fushën administrative në sipërmarrje apo shoqëri konsulence apo studio profesionale.
4. Drejtuesi i ngarkuar me mbajtjen e dokumentave kontabël të shoqërisë mund të largohet nga detyra me vendim të këshillit të administrimit, kundrejt opinionit të Bordit të Audituesve, vetëm me arsye.
5. Drejtuesi i ngarkuar me mbajtjen e dokumentave kontabël të shoqërisë largohet nga detyra në mungesë të kushteve të nevojshme për të ushtruar detyrën. Largimi nga detyra deklarohet nga këshilli i administrimit brenda tridhjetë ditëve nga marrja dijeni e situatës së krijuar.
6. Drejtuesi i ngarkuar me mbajtjen e dokumentave kontabël të shoqërisë përgatit procedura të përshtatshme administrative e kontabël për mbajtjen e bilancit të vitit ushtrimor dhe, nëse parashikohet, të bilancit të konsoliduar.
7. Këshilli i administrimit kontrollon që drejtuesi i ngarkuar me mbajtjen e dokumentave kontabël të shoqërisë të ketë tagrat dhe mjetet e duhura për ushtrimin e detyrave që i janë dhënë, si edhe që u përmbahet realisht procedurave administrative e kontabël.
8. Administratori i deleguar dhe drejtuesi i ngarkuar me mbajtjen e dokumentave kontabël të shoqërisë vërtetojnë me një relacion të posaçëm, bashkëlidhur bilancit të vitit ushtrimor dhe, nëse parashikohet, bilancit të konsoliduar, përshtatshmërinë dhe aplikimin real të procedurave sipas paragrafit 6, gjatë vitit ushtrimor të cilit i referohet dokumentacioni, si edhe përputhjen e këtyre me sa rezulton nga regjistrat dhe librat kontabël dhe përshtatshmërinë e tyre për të paraqitur në mënyrë të vërtetë e korrekte gjendjen pasurore, ekonomike e financiare të shoqërisë dhe, nëse parashikohet bilanci i konsoliduar, të tërësisë së sipërmarrjeve të përfshira në konsolidim.

BILANCI – FITIMET

Neni 16
(Viti ushtrimor)

1. Viti ushtrimor mbyllet më datë 31 dhjetor të çdo viti.
2. Asambleja që aprovon bilancin vendos mbi ndarjen e fitimit.
3. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci ndahen si vijon:
 - 5% (pesë për qind) shkon për fondin e rezervës ligjore deri sa kjo shumë të arrijë 20% (njëzetë për qind) të kapitalit të shoqërisë;
 - pjesa e mbetur ndahet sipas sa vendoset nga Asambleja.

4. Pagesa e dividendit kryhet me mënyrat, në vendet dhe sipas kushteve të përcaktuara nga organi administrativ. Dividentët e patërhequr brenda një periudhe pesëvjeçare nga dita në të cilën janë të disponueshëm, shkojnë në favor të shoqërisë.

SHPËRBËRJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 17 (Shpërbërja dhe likuidimi)

Nëse janë kushtet, në çdo kohë dhe për çfarëdolloj arsyeje, për shpërbërjen e shoqërisë, asambleja do të përcaktojë mënyrat e likuidimit dhe do të emërojë një apo disa likujdues duke përcaktuar kriteret në bazë të së cilave duhet të bëhet likuidimi, tagrat dhe pagesat përkatëse.

Neni 18 (Referime)

Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, shoqëria i referohet ligjit civil dhe ligjeve të posaçme.

Nënshkruar nga PAOLO CASTELLINI – Noter

Kopje e njëjtë me origjinalin e pajisur me firmat sipas ligjit.

Lëshohet nga unë, Znj. ANGELA CIANNI, Notere në Romë, asistente e përkohshme e Z. PAOLO CASTELLINI, Noter në Romë, të dy të regjistruar në Dhomën Noteriale të Rajoneve të Bashkuara të Roma-s, Velletri-t e Civitavecchia-s dhe me studio në Roma, në adresën: Via Orazio n. 31, emëruar me vendimin prot. n. 1750, datë 27 korrik 2021, të Kryetarit të Këshillit Noterial të Rajoneve, si më sipër, të Bashkuara të Roma-s, Velletri-t dhe Civitavecchia-s.

PA PULLË PËR T'U PËRDORUR ATY KU E LEJON LIGJI

Kjo kopje është e përbërë nga dyzetë e shtatë faqe.

Roma, më gjashtë gusht dy mijë e njëzetë e një.

(firmë dhe vulë)

MARCA DA BOLLO
 Ministero dell'Economia e delle Finanze €16,00
 SEDICI/00

agenzia entrate
 01002114 0000757A WD1KT001
 00321505 30/08/2021 18:02:39
 4578-00088 DOCDC31B2DAA4246
 IDENTIFICATIVO : 01201265981529

0 1 20 126598 152 9

MARCA DA BOLLO
 Ministero dell'Economia e delle Finanze €16,00
 SEDICI/00

agenzia entrate
 01002114 0000757A WD1KT001
 00321506 30/08/2021 18:02:45
 4578-00088 7433F558F54C9CEC
 IDENTIFICATIVO : 01201265981518

0 1 20 126598 151 8

MARCA DA BOLLO
 Ministero dell'Economia e delle Finanze €16,00
 SEDICI/00

agenzia entrate
 01002114 0000757A WD1KT001
 00321507 30/08/2021 18:02:52
 4578-00088 D832C6C628ED1741
 IDENTIFICATIVO : 01201265981507

0 1 20 126598 150 7

MARCA DA BOLLO
 Ministero dell'Economia e delle Finanze €16,00
 SEDICI/00

agenzia entrate
 01002114 0000757A WD1KT001
 00321508 30/08/2021 18:02:58
 4578-00088 1D2A452EF05DESFB
 IDENTIFICATIVO : 01201265981494

0 1 20 126598 149 4

MARCA DA BOLLO
 Ministero dell'Economia e delle Finanze €16,00
 SEDICI/00

agenzia entrate
 01002114 0000757A WD1KT001
 00321509 30/08/2021 18:03:05
 4578-00088 F135D264F75CE45C
 IDENTIFICATIVO : 01201265981483

0 1 20 126598 148 3

MARCA DA BOLLO
 Ministero dell'Economia e delle Finanze €16,00
 SEDICI/00

agenzia entrate
 01002114 0000757A WD1KT001
 00321511 30/08/2021 18:03:18
 4578-00088 E4A2FE61944590E3
 IDENTIFICATIVO : 01201265981461

0 1 20 126598 146 1

MARCA DA BOLLO
 Ministero dell'Economia e delle Finanze €16,00
 SEDICI/00

agenzia entrate
 01002114 0000757A WD1KT001
 00321510 30/08/2021 18:03:12
 4578-00088 F891DCC316EB803A
 IDENTIFICATIVO : 01201265981472

0 1 20 126598 147 2



TRIBUNALE ORDINARIO DI ROMA

Ufficio Asseveramento Perizie e Traduzioni

VERBALE DI GIURAMENTO

CRONOLOGICO N. 5723-z

Addì **31 agosto 2021** avanti al sottoscritto Cancelliere è presente il signor **Luciano Pistillo** identificato con documento **Patente auto N° U11W65355Y** rilasciata da **MIT-UCO** il **16.10.2020** il quale chiede di asseverare con giuramento la traduzione dalla lingua ITALIANA alla lingua ALBANESE dei seguenti documenti:

Copia conforme del deposito di documenti nell'interesse di **ITALIA TRASPORTO AEREO SPA** presso il Notaio **Paolo Castellini, Roma**

~~unito in originale/copia conforme all'originale/fotocopia semplice:~~

Il Cancelliere, previa ammonizione sulla responsabilità penale (art. 483 c.p.) derivante da dichiarazioni mendaci, invita il comparente al giuramento, che egli presta ripetendo: **"Giuro di avere bene e fedelmente adempiuto all'incarico affidatomi al solo scopo di far conoscere la verità"**.

Letto, confermato e sottoscritto.



IL FUNZIONARIO GIUDIZIARIO
(*Nadia Di Genova*)

N.B. L'Ufficio non si assume alcuna responsabilità per quanto riguarda il contenuto e la regolarità formale del documento tradotto.

APOSTILLE

(Convention de la Haye du 5 octobre 1961)

1. Paese **ITALIA**

Il presente atto pubblico

2. è stato sottoscritto da **NADIA DI GENOVA**

3. agente in qualità di **FUNZIONARIO GIUDIZIARIO**

4. è munito del sigillo/bollo di **Tribunale Ordinario di Roma**
Tribunale Ordinario di Roma

Attestato

31 AGO, 2021

5. in **ROMA**

6. il

7. da **PROCURA DELLA REPUBBLICA DI ROMA**

8. col numero **3695/4**

9. sigillo/timbro dell'Ufficio legalizzazioni

10. Firma



Dir. Amm. Delegato alla Legalizzazione
Dott. Ferdinando Correale

(Handwritten signature)

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË ROMË

Zyra e Verifikimit Ekspertizës dhe Përkthimeve

PROCESVERBAL BETIMI

Kronologjia Nr. 5723 - 2

Sot më datë 31 gusht 2021 përpara Kancelarit të nënshkruar është prezent

Zoti **Luciano Pistillo**

i identifikuar me anë të dokumentit Leje drejtimi N.U11W65355Y lëshuar nga MIT-UCO më 16.10.2020

i cili kërkon të vërtetojë me betim përkthimin

nga gjuha ITALIANE në gjuhën SHQIPE

të dokumentave të mëposhtëm:

Kopje e njëjtë me origjinalin të dokumentave të depozituara në favor të ITALIA
TRASPORTO AEREO SPA pranë Noterit Paolo Castellini, Romë

Bashkëlidhur: kopja e njëjtë me origjinalin

Kancelari, duke vënë në dijeni paraprakisht mbi përgjegjësitë penale (neni 483 k.p.) të ardhur nga deklarata e rreme, e fton palën paraqitëse në betim, duke përsëritur: **“Beto hem se do ta kryej mirë dhe me besnikëri detyrën e besuar me qëllimin e vetëm për të zbardhur të vërtetën”**.

Lexuar konfirmuar dhe nënshkruar

Nënshkrimi

Funksionari gjyqësor
Firmë e vulë

Shënim Zyra nuk merr përsipër përgjegjësi lidhur me përmbajtjen dhe rregullsinë formale të dokumentit të përkthyer.

Perkthyes zyrtar
Vjollca META





APOSTILE

Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961

1. Shteti: ITALI
2. Ky akt publik është firmosur nga: NADIA DI GENOVA
3. Në cilësinë e Funkionarit Gjyqësor
4. Është pajisur me firmë dhe vulë nga : Gjykata e Shkallës së Parë Romë

Vërtetohet

5. Në Romë
6. Me datë 31 gusht 2021
7. Nga PROKURORIA E REPUBLIKËS ROMË
8. Me Numër 3695/4
9. Vulë Zyra e legalizimeve
10. Firmë

Drejtuesi Administrativ i Deleguar për Legalizime
Dr. Ferdinando Correale
vulë dhe firmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË DHOMA
KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MANUSHAQE H. JAUPI

DATE 10/09/2021
NR REP 7391



VËRTETIM PËRKTHIMI

Vertetoj nënshkrimin e përkthyesit Z/Znj Vjollca Meta, e bija biri e/i Ismail, lindur më 24/01/1973, në Midhë, Mat dhe banuese në TIRANË, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim/pasaportë me nr. 032561967 dhe Nr. Personal H35124072B, përthyes i licensuar nga Ministria e Drejtësisë e/i cili/a deklaroi se perktheu njësoj me origjinalin dokumentin bashkalidhur , nga gjuha italiane në gjuhën shqipe.

Unë, noterja, duke gjetur këtë akt në përputhje me ligjin, e vërtetoj atë, në bazë të nenit 135 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

NOTER

Manushaqe Jaupi

**NOTERE
MANUSHAQE JAUPI
TIRANE - ALBANIA**